

LegalNews

Gusht 2018
August 2018



I. Ligji nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim

Ky ligj u aprovua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare më 20 Gusht 2018. Ligji hynë në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Me këtë ligj shfuqizohet ligji i mëhershëm i ndërmjetësimit i cili ishte në fuqi që nga viti 2008.

Ligji rregullon mënyrën, funksionin, procedurat si dhe organizimin e ndërmjetësimit, të drejtat dhe detyrimet e ndërmjetësuesve sa i përket facilitimit të zgjidhjes alternative të kontesteve, si dhe lejimin e qasjes në zgjidhjen alternative të kontesteve.

Një risi sa i përket këtij ligji është dispozita e "ndërmjetësimit të detyrueshëm" e cila aplikohet në rastet në rastet si: alimentacioni, kujdestaria, kontaktet, mbajtja e fëmijës dhe ndarjen e pronës së përbashkët martesore, kontestet pronësore që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet nga të drejtat e servituteve, dhe kompensimi i pronës së shpronësuar.

Kur palët parashtrojnë kërkesëpadi në gjykatë, për çështjet si më sipër, gjyqtari në seancën përgatitore dhe pas shqyrtimit paraprak të kërkesëpadisë, detyrohet të informojë dhe udhëzojë palët në procedurën e ndërmjetësimit. Ky nen i vë në dispozicion të palëve 30 ditë që të arrijnë një marrëveshje.

Në rast të mos arritjes së marrëveshjes, palët duhet të prezantojnë prova se kanë tentuar të arrijnë marrëveshje me ndërmjetësim, dhe vetëm pastaj mund të vazhdojnë me procedurat gjyqësore.

I. Law No. 06/L-009 on Mediation

This Law was approved by the Assembly of the Republic of Kosovo and has been published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo on 20 th of August.

It shall enter into force 15 days after its publication in the Official Gazette.

This repeals the old Mediation Law that was in force since the year 2008. The Law regulates the manner, functioning, procedures and organization of mediation, as well as the rights, duties and responsibilities of mediators in terms of facilitating access to alternative dispute settlements of and contests, and also promotes their amicable settlement.

A notable addition to the new law is the "mandatory mediation" which is applicable for matters such as: custody procedures, alimony, visits, child support and division of marital property, ownership contests related to rights and obligations deriving from rights of servitudes and compensation of expropriated properties.

When parties file a statement of claim before a court for any of the above cases, the judge in the preliminary hearing, after the preliminary review, is obliged to inform and direct parties to mediation procedure.

The parties have 30 days to reach an agreement. If there is no agreement, parties must provide evidence that they have tried mediation, and only then can continue with the judicial proceedings.

II. Konventa mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Austrisë për eliminimin e Tatimit të dyfishtë, të tatimeve në të ardhura si dhe parandalimin e evazionit dhe shmangies Fiskale

Kjo konventë është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 1 gusht 2018 dhe aplikohet ndaj personave që janë rezident të shteteve nënshkruese, Kosovës dhe Austrisë.

Kjo konventë e mbulon taksimin në bazë të të ardhurave në emër të Kosovës ose Austrisë pavarësisht mënyrës së inkasimit. Për më tepër, tatimet mbi të hyrat përfshijnë të gjitha tatimet që grumbullohen nga të hyrat e përgjithshme ose të pjesëshme, tatimin në fitim si rrjedhojë e tjetërimit të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, tatimin mbi pagë si dhe tatimin mbi vlerësimin e kapitalit.

Po ashtu rregullohen çështjet si dividenda, interesi, tantiemat, fitimet nga tjetërsimi i kapitalit, të ardhurat nga punësimi dhe pagesat e drejtorëve të bordeve të kompanisë, artistët dhe sportistët, pensionet, shërbimi qeveritar, studentët dhe të ardhura të tjera.

Sa i përket çështjes së eliminimit të tatimit të dyfishtë të dy shtetet pajtohen të zbresin prej taksave në të hyra të njëjtën shumë e cila paguhet në shtetin tjetër. (P.sh. një Austriak i cili është taksuar në të ardhura e tij në Kosovë, do të bëhet zbritje nga shteti Austriak në shumën e njëjtë, kjo vlen edhe anasjelltas).

II. Convention between The Republic of Kosovo and The Republic of Austria for the elimination of double taxation with respect to taxes on income and prevention of tax evasion and avoidance

This convention has been published on the Official Gazette of the Republic of Kosovo on 1 st August 2018 and applies to persons who are residents of the signatory states, both Kosovo and Austria.

This Convention covers taxes on income imposed on behalf of Kosovo or Austria, irrespective of the manner in which they are levied. Furthermore, taxes on income include taxes on gains from alienation of movable or immovable property, taxes on total amounts of wages or salaries paid by enterprises and also taxes on capital appreciation.

What is more, this convention regulates the issues of dividends, interest royalties, capital gains, income from employment, director fees, entertainers and sport persons, pensions, government service, students and other income.

As it pertains the elimination of double taxation, both countries agree to deduct from tax on income the same amount to the income tax paid in the other country (i.e. an Austrian that has been taxed on her/his income in Kosovo, will be granted a deduction by Austria in the equal amount and vice versa).

III. Ligji nr. 06-L080 për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Unionit "Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) 2014-2020"

Ky ligj ratifikon Marrëveshjen "COMSE" mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian që është nënshkruar më 19 Dhjetor 2017 dhe është publikuar më 8 Gusht 2018. Hynë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Programi "COSME" ka për qëllim që të ndihmojë bizneset e vogla dhe të mesme në mënyrë që stabiliteti ekonomik të vazhdojë të zhvillohet, si dhe këto biznese të kenë një mënyrë qasje në fondet e Bashkimit Evropian, përmes ndërmjetësuesve financiar.

Në pajtim me këtë Ligj, Komisioni Evropian dhe Republika e Kosovës, do të monitorojnë në vazhdimësi këtë proces, si dhe shteti i Kosovës do të raportoj në Komision specifikat e mbarëvajtjes së projektit.

IV. Udhëzimi Administrativ nr. 07/2018 për përcaktimin e procedurës së Licencimit për subjektet që ushtrojnë veprimtari në sektorin e Naftës

Ky udhëzim administrativ rregullon procedurën e licencimit të entiteteve në sektorin e Naftës, i cili merret me import, deponimin, shitjen me shumicë dhe shitjen me pakicë, produktet e naftës dhe derivateve të saj në Kosovë.

III. Law No. 06-L080 on Ratification of the Agreement between Kosovo in the European Union Programme "Competitiveness of Enterprises and Small and Medium-Sized Enterprises (COSME) 2014-2020"

This law ratifies the "COSME" Agreement between Kosovo and the European Union that has been signed on 19 th December 2017 and was published on 08 August 2018.

It entered into force 15 days after its publication. With the intention to help the small and medium enterprises the COSME program will further help the economic stability and facilitate access to EU funding through financial intermediaries.

In accordance with this law The Commission and the Kosovo continuously will monitor the process and also Kosovo shall report the specifics of the project to the Commission for evaluation.

IV. Administrative Instruction No. 07/2018 on Determination of the Licensing Procedures for Entities dealing in Petroleum sector activities

This Administrative Instruction sets out the licensing procedure of business entities, and the types of licenses in the petroleum sector that deal with import, storage, retail and wholesale of the petroleum and petroleum products in Kosovo. In addition this Administrative Instruction Abolishes Administrative Instruction 07/2010.

Për më tepër, ky udhëzim administrativ e shfuqizon Udhëzimin Administrativ 07/2010. Udhëzimi Administrativ është publikuar më 16 Gusht 2018 dhe hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit dhe nënshkrimit të Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë.

Në mënyrë që entitetet të ushtrjnë aktivitete si importi, deponimi, shitja me shumicë dhe shitja me pakicë, e produkteve të naftës dhe derivateve, atëherë duhet të aplikohet në Departamentin për Licencim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Produktet e naftës për të cilat kërkohet licencë janë:

- Dizelli;
- Benzina;
- GLN për automjete;
- GLN për ngrohje;
- Karburanti Jet;
- Vajguri;
- Gazoili;
- Vajrat e rënda për ngrohje;
- Koksi i naftës;

Poashtu kërkohet Licencë për disa lloje të caktuara (vajrat për qëllime: lubrifikimi, hidraulike, përcjellje të nxehtësisë, kundër ndryshkjes, izolim elektrik, punim të metaleve si dhe tretje për qëllime të tjera të ngjashme).

V. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2018 për mënyrën, procedurat dhe afatet e pagesës mujore për punëdhënësit të cilët nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuar

Udhëzimi administrativ është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 22 Gusht 2018 dhe hynë në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit të ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale.

This Administrative Instruction has been published on 16 th of August 2018 and entered into force 7 days after its publication and the signing from the Minister of Trade and Industry.

In order for entities that deal in import, storage, retail, wholesale of petroleum and petroleum products need to apply for a license from the Licensing department of MTI.

Oil products for which a license is required are:

- Diesel;
- Gasoline;
- LPG for Vehicles;
- LPG for heating;
- Jet fuel;
- Kerosene;
- Gasoil;
- Heavy oils for heating;
- Petroleum coke;

Also certain oil by-products need licensing (oils for purposes of: lubrication, hydraulic, heat transfer, anti-corrosion electrical insulation, metal processing, and dissolution for other similar purposes).

V. Administrative instruction No. 03/2018 on the manner, procedures and deadlines for monthly payment for Employers who do not employ persons with disabilities.

The Administrative Instruction has been published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo on 22 nd of August 2018, and has entered into force 7 days after the signature of the Minister of Labor and Social Welfare.

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të rregullojë mënyrën, procedurat dhe afatet e pagesës mujore për punëdhënësit të cilët nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuar.

Ky udhëzim është nxjerrë në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Sipas neni 12 par.2 të këtij ligji, çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuar për çdo 50 punëtorë. Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i nenit 12 të ligjit, obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara të paguajë në një xhirollogari të veçantë në vijën buxhetore të Buxhetit të Kosovës, pagesat mujore në lartësi të shumës së pagës minimale të realizuar në Republikën e Kosovës, për çdo person me aftësi të kufizuar që duhet të kishte punësuar.

Këto dispozita aplikohen për institucione shtetërore, punëdhënësit të sektorit privat dhe atij publik si dhe organizatat jo qeveritare që nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuara.

Këto dispozita nuk aplikohen për punëdhënësit e rinjë të cilët nuk i kanë kaluar 24 muaj nga data e regjistrimit të aktiviteteve të tyre.

Pagesa do të bëhet çdo 3, 6 dhe 12 muaj. Punëdhënësit janë të obliguar të paguajnë shkallën më të ulët të shumës së pagës minimale të realizuar në Republikën e Kosovës, për çdo person me aftësi të kufizuar që do të duhej të punësonin.

The purpose of this Administrative instruction is to regulate the manner, procedures and deadlines for monthly payment for employers who do not employ persons with disabilities.

This Administrative Instruction has been published in accordance with Law No. 03/019 on vocational ability, rehabilitation and employment of people with disabilities. According to Article 12 par.2 of this law, each employer is obliged to employ a person with disability, in every 50 employees. An Employer that does not fulfill the obligations set forth in para.1 and 2 of article 12 of the base Law, is obliged that for the promotion of the employment of people with disabilities, to pay, in a special account budgetary line in Kosovo's budget, monthly payments in the amount of minimum salary in the Republic of Kosovo, for every person with disabilities that would have been hired.

These provisions apply to state administration bodies, private and public sector employers as well as non-governmental organizations that do not employ persons with disabilities.

These provisions do not apply for new employers within the 24 months from the date of registration of their activities.

The payment shall be made every 3, 6 and 12 months. Employers are obliged to pay the lowest rate of minimum wage amount realized in the Republic of Kosova for every person with a disability that should have hired.

Deloitte Contacts

Afrore Rudi

Director | Tax & Legal Services
Deloitte Kosova sh.p.k

Str. Lidhja e Pejes, No. 177
10000 Prishtina, Republic of Kosovo
Cell: +386 (0)49 590 807
Email: arudi@deloittece.com

Ardian Rexha

Senior legal Associate | Tax & Legal Services
Deloitte Kosova sh.p.k

Str. Lidhja e Pejes, No. 177
10000 Prishtina, Republic of Kosovo
Cell: +386 (0)49 780 430
Email: arrexha@deloittece.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 263,900 professionals are committed to becoming the standard of excellence.